



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN
2020**

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Goran Rakić, Ministër

Adresa: Sheshi “Nëna Terezë”, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në nenin 19.3.1 të Raportit Vjetor Financiar nuk ishte e saktë. Pasuritë ishin mbivlerësuar për 412,870€.
- A2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 €) të prezentuara në nenin 19.3.2 të Raportit Vjetor Financiar, ishin të mbivlerësuara për 162,362€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë për Komunitete dhe Kthim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Ishin bërë pagesa të parregullta në vlerë 103,562€, për të punësuarit me marrëveshje të Brukselit

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Ne kemi vërejtur se në pesë (5) pagesa, ministria kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 248,130€. Pagesat ishin bërë nga kategoria investime kapitale të cilat për nga natyra i përkasin kategorisë subvencione dhe transfere. Këto mjete ishin të buxhetuara me Ligjin nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se menaxhimi i shpenzimeve dhe pasurive ka nevojë për përmirësim. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do ti përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësim i pasurive mbi 1,000€

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Vlera e pasurisë (18,428,499€) e prezantuar në nenin 19.3.1 ‘Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk ishte e saktë. Kjo për shkak se, 18 shtëpi të banimit për të kthyerit në vlerë 252,960€, për të cilat ishte bërë pranimi teknik gjatë vitit 2020, ekzistojnë ende në regjistrin e pasurive të organizatës si investim në vijim dhe nuk ishte bartur pronësia tek përfituesit.

Më tej, në dy raste kemi vërejtur që pagesat e bëra nga kategoria investime kapitale në vlerë prej 159,910€ të cilat për nga natyra e shpenzimit i takojnë kategorisë subvencione, janë regjistruar në regjistrin e pasurive të Ministrisë pa i përmbushur kriteret për tu njohur si pasuri kapitale. Këto pagesa janë transferuar në llogari të Këshillit Danez për Refugjatë për projektin “Mbështetje e qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive“ në vlerë 50,000€ dhe për projektin “Pagesa e qirasë për të kthyerit në vlerë prej 109,910€.

Kjo ka ndodhë për shkak të mos respektimit/zbatimit të kërkesave të rregullave financiare për menaxhimin dhe raportimin e pasurisë.

Ndikimi

Mos bartja e pasurive tek përfituesit si dhe mos azhurnimi i regjistrit të pasurive ndikon që vlera e pasurive kapitale e raportuar në RVF të jetë e pa saktë.

Rekomandimi A1

Ministri të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë tek përfituesit dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë. Më tutje, Ministri të sigurohet se pagesat të cilat nuk i takojnë kategorisë së investimeve kapitale të mos përfshihen në regjistrin e pasurisë dhe në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Prezantim jo i drejtë i pasurisë nën 1,000€

Gjetja

Sipas rregullës financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 24-raportimi, pika 3-paraqitja e pasurisë financiare dhe jo financiare në PVF do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Pasuritë e prezantuara në nenin 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 €) nuk ishin të prezantuar drejtë sepse ato ishin prezantuar me vlerë bruto e cila ishte 212,266€, përderisa duhej të regjistroheshin në bazë të vlerës kontabël neto, ku vlera neto duhet të ishte 49,904€. Si rezultat i kësaj pasuritë e prezantuara në RVF, janë mbivlerësuar në vlerë prej 162,362€. Vlera bruto e paraqitur në RVF përfshin zhvlerësimin e akumuluar dhe vjetor.

Kjo ka ndodhë për shkak të mos respektimit/zbatimit të kërkesave të rregullës financiare për menaxhimin dhe raportimin e pasurisë.

Ndikimi

Prezantimi i pasurive në pasqyrat vjetore financiare sipas vlerës bruto/fillestare, ndikon në mbivlerësimin e tyre dhe rezulton në raportim jo të drejtë në RVF.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurohet që vlera e pasurisë të raportohet sipas vlerës neto, siç kërkohet me rregullën financiare në mënyrë që të siguroj raportim cilësor, të drejtë dhe të vërtetë në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri në punë dhe pa realizim të detyrave

Gjetja

Rregullorja 05/2010 (neni 7) e shfuqizuar në gusht 2020 me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve (neni 8), përcaktojnë se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik.

Në kemi vërejtur që në MKK, mungojnë dëshmitë për vijueshmërinë në punë për njëzet (20) punonjës të saj. Të njëjtit asnjëherë nuk figurojnë në regjistrin e ardhje vajtjeve në punë gjatë vitit 2020 përderisa kompensimi vjetor për këta të punësuar ishte 103,562.40€. Për më tepër, nuk ka dëshmi për realizimin/kryerjen e punëve në përputhje me përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësisë që u janë ngarkuar.

Përveç këtyre, edhe në një rast (Udhëheqësi i Divizionit për planifikim të politikave) kemi vërejtur që nuk kishte dëshmi për vijueshmërinë në punë për periudhën e ekzaminuar nëntor 2020.

Shkaku i mos paraqitjes në punë të këtyre zyrtarëve ishte mos krijimi i kushteve të duhura për punë, kontrolli i dobët dhe mos monitorimi i tyre nga menaxhmenti i ministrisë. Ndërsa për punonjës të Udhëheqësi i Divizionit për planifikim të politikave, sipas zyrtarëve përgjegjës, shkak ishte mungesa e kartelës.

Ndikimi

Mos vijueshmëria në punë dhe mos realizimi i detyrave dhe përgjegjësisë në përputhje me akt emërimet është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe paraqet shembull jo të mirë tek punonjës të tjerë. Kompensimi i tillë i zyrtarëve e dëmton buxhetin dhe reputacionin e organizatës në përgjithësi, gjithashtu e rrit rrezikun që organizata të dështoj në realizimin e objektivave të saja.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj kontrole adekuate në fushën e personelit, të zgjidhë problemin e angazhimit të punonjësve në punë dhe të ndërmerren hapat e duhur për zbatimin e legjislacionit në fuqi duke siguruar menaxhim efikas dhe efektiv të organizatës në drejtim të realizimit të objektivave të saja.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A3 - Prezantimet/paraqitjet jo të duhura në PFV-të 2020

Gjetja Kërkesë e Rregullores MF-nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore është që të gjitha shifrat e prezantuara në Pasqyrat Vjetore financiare (PVF) të jenë të sakta dhe të plota.

Tek Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit tek kolona e buxhetit fillestar dhe final tek pjesa hyrja e parasë së gatshme Të hyrat jo tatimore, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë. Sipas informimit të dërguar nga MF për projeksionet e të hyrave datë 27.01.2021, të hyrat jo tatimore në buxhetin fillestar ishin 4,021€ ndërsa në buxhetin me rishikim/final ishin 3,345€.

Gjithashtu, këto çështje/mangësi janë përcjellë edhe në shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit (neni 14.6).

Gabimi në PFV lidhur me buxhetin fillestar dhe final të të hyrave jo tatimore ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve të ministrisë gjatë hartimit të PVF.

Ndikimi Mos prezantimi i drejtë i shënimeve në PFV përveç që është jo në harmoni me rregulloren përkatëse ndikon në ofrimin e informatave jo të sakta dhe çorientuese për shfrytëzuesit e PVF.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të ndërmarrë masa konkrete që të eliminoj mangësitë e evidentuara lidhur me raportimin e buxhetit të të hyrave jo tatimore në mënyrë që në të ardhmen PFV-të të pasqyrojnë pamje të plotë dhe të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 18,428,499€, pasurive jokatitale është 212,266€, si dhe e stoqeve 12,664€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 2,848,463€ (prej tyre 50 mostra blerje gjatë vitit 2020 në vlerë 2,817,367€, një mostër pasuri mbi 1,000 në vlerë 26,035€, 14 mostra pasuri nën 1,000 në vlerë 3,519€ dhe 5 mostra stoqe në vlerë 1,540€). Gjithashtu, kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për procedura.

Çështja A4 - Mangësi në regjistrin e pasurisë

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, pika 1 dhe 2 (Regjistri i pasurive jo financiare) parasheh që "çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël"

Në regjistrin e pasurisë është vërejtur që të gjitha klasat e pasurisë janë të regjistruara vetëm me një numër identifikues dhe si vlerë totale e tyre. Regjistrimi është dashur të bëhej ndaras me numra të ndryshëm të identifikimit për secilin zë të pasurisë.

Kjo ka ndodhë për shkak të njohurive të pa mjaftueshme të zyrtarëve përgjegjës për aplikimin e duhur të kërkesave të dala nga rregulloret financiare për menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë në mënyrë të ndarë për secilin zë ndikon në cilësinë e regjistrave të pasurisë dhe raportimit të tyre. Rrjedhimisht, kjo gjendje ka shkaktuar një pasqyrë jo të drejtë të regjistrit kontabël të pasurive.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që regjistrat e pasurisë plotësohen dhe azhurnohen sipas kërkesave të rregulloreve në fuqi në mënyrë që këta regjistra të jenë të plotë dhe të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë

Gjetja Sipas rregullës financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 19 komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare, pika 5.2 emërimi i komisionit për inventarizim të pasurisë jo financiare, si dhe neni 4.7 parasheh hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në kohën përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe shqyrtimin e diferencave në mes gjendjes kontabël dhe dëmtimeve të konstatuara.

Gjatë vitit 2020, ministria nuk kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive dhe vlerësimin e tyre dhe si rezultat i kësaj nuk ishte bërë inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive për këtë periudhë.

Kjo ka ndodhë për shkak të mos respektimit/zbatimit të kërkesave të rregullës për menaxhimin e pasurive sa i përket inventarizimit dhe vlerësimin të pasurive.

Ndikimi

Mungesa e formimit të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurive si dhe mungesa e raporteve të inventarizimit dhe vlerësimin të pasurisë, ndikon në cilësinë e regjistrave të pasurive dhe raportimit të tyre në PVF.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të siguroj që në mënyrë periodike, para përfundimit të vitit fiskal dhe para përgatitjes së PVF-ve të caktohet komisioni për inventarizim dhe sipas nevojës komisioni për vlerësim të pasurisë, në mënyrë që regjistrat e pasurive dhe raportimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 9,654€ . Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja A5 - Mos protokollimi i faturave të pranuar

Gjetja Sipas rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 24 - pranimi dhe pagesa e faturës, pika 1.3 theksohet që fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave, duke i zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit.

Si rezultat i mostrave të ekzaminuara/audituar, kemi vërejtur që faturat pranohen nga një zyrtar dhe evidentohen në librin e faturave ku vendoset data e pranimi të tyre mirëpo të njëjtat nuk protokollohen.

Mos protokollimi i faturave sipas rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike ka rrjedhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve të ministrisë.

Ndikimi Mos protokollimi i faturave të pranuar rritë rrezikun që ato mos të regjistrohen në kohë, të mos raportohen detyrimet sipas faturave dhe të shkaktohen vonesa në pagesën e tyre.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislacionit në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	7,013,261.00	4,572,198.33	4,090,934.78	7,304,290.99	8,223,450.00
Grante Qeveritare - Buxheti	7,013,261.00	4,572,198.02	4,090,934.78	6,349,654.42	8,223,450.00
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	0.00	0.00	954,636.57	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	0.31	0.00	0.00	0.00

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 2,441,063€. Buxheti është zvogëluar fillimisht në vlerë prej 2,251,147€ si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për Ndarjet Buxhetore (Ligji nr. 07/L014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr. 07/L001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020). Më pas është zvogëluar për 189,916€, përmes vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2020 MKK ka shpenzuar 4,090,935 € (89.47% të buxhetit përfundimtar), me një ulje rreth 7.5% në krahasim me vitin 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	7,013,261.00	4,572,198.33	4,090,934.78	7,304,290.99	8,223,450.00
Pagat dhe mëditjet	838,442.00	740,941.79	739,819.16	870,563.43	878,955.43
Mallrat dhe shërbimet	357,819.00	228,374.31	203,197.36	362,799.95	378,694.64
Komunalitë	17,000.00	5,883.93	4,759.28	10,838.35	8,378.16
Subvencionet dhe transferet	300,000.00	291,855.99	288,398.99	288,324.81	299,925.02
Investimet Kapitale	5,500,000.00	3,305,142.31	2,854,759.99	5,771,764.45	6,657,496.75

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti fillestar për paga dhe mëditje ishte 838,442€, ndërsa buxheti final 740,942€. Kjo kategori ishte zvogëluar për 97,500€ si rezultat i vendimit të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020;

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 129,445€. Zvogëlimi në vlerë 48,000€ ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore si dhe zvogëlimi në vlerë 81,445€ me vendime të Qeverisë (28,820€ me vendimin 09/50 dhe 52,625€ shkurtime në fund të vitit);


Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 11,116€. Zvogëlimi në vlerë prej 8,289€ ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore, dhe zvogëlimi prej 2,827€ me vendim të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020;

Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 8,144€. me vendim të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020;


Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale është zvogëluar për 2,194,858€. Zvogëlimi ishte bërë në bazë të Ligjit nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore.

Për më tepër, MKK, gjatë vitit 2020 ka realizuar shpenzime për Covid 19 në vlerë prej 34,637€. Ato janë kryesisht subvencione. Ne kemi testuar tri (3) mostra në vlerë prej 23,135€ mirëpo nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi në menaxhimin e këtyre shpenzimeve.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Sipas projeksionit të të hyrave të datës 27.01.2021, buxheti fillestar i të hyrave jo tatimore ishte 4,021€ ndërsa pas rishikimit ishte 3,345€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	4,021.00	3,345.00	1,819.00		
Të hyrat jo tatimore	4,021.00	3,345.00			
Të hyrat tjera	0.00	0.00	1,819.00		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të MKK-së ka rezultuar me tetë (8) rekomandime kryesore. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku ka prezantuar mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna duke përfshirë personat përgjegjës dhe afatet kohore për secilin rekomandim.

Menaxhmenti i MKK-së ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, ku deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, katër (4) rekomandime ishin zbatuar, përderisa dy (2) nuk janë zbatuar, dhe dy (2) i kemi trajtuar të mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë Tabelën e rekomandimeve.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi identifikuar përsëri mangësi të tilla.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo ridestinin të mjeteve) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi identifikuar mangësi të tilla mirëpo në këtë vit (2020) nuk e kemi paraqitur si rekomandim sepse të njëjtën e kemi paraqitur vetëm tek theksimi i çështjes	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurohet që me rastin e mbylljes së avansit të ketë arsyetime me dëshmi të pranuar për aktivitete zyrtare. Gjithashtu, të shtohen kontrollet me rastin e pranimit të faturave dhe realizimit të pagesave, në mënyrë që praktikat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të marrë veprimet e nevojshme për identifikimin e kriterëve dhe vendosjen e kontrolleve kyçe të cilat do ta lehtësonin procesin e monitorimit të subvencioneve.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të projekteve kapitale, paraprakisht bëhet një vlerësim i hollësishëm duke planifikuar dhe specifikuar saktë të gjitha komponentat e projektit me të gjitha detajet e duhura dhe më pas të përfshihen në planin buxhetor.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi vërejtur që këto projekte planifikohen në projekte për kthim (ndërtimi i shtëpive për te kthyerit), projekti për komunitete dhe projekti rrk - IV-. Për shkak të rëndësisë së ulët, të njëjtin e kemi trajtuar të mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Investimet kapitale	Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar për ndërtimin e shtëpive dhe mos banimin e tyre duke vlerësuar në mënyrë më strikte nevojat e përfituesve të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e rregullores për asistencë nga ministria. Në anën tjetër, të siguroj që mbikëqyrja e projekteve të jetë më efektive për t'u siguruar që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se zyra e prokurimit nuk do të bëj iniciimin e procedurave të prokurimit për kontratat e punës pa posedimin e projektit ekzekutiv.	Gjatë auditimit për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	I zbatuar

8.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që anëtarët e komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë të emërohen nëpunës kompetent dhe profesional që do të mundësonin inventarizimin e plotë, në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu, investimet e kryera të regjistruara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim në momentin që projekti kapital përfundon, duhet të bëhet transferi tek përfituesit dhe të largohen nga regjistri i pasurisë.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi identifikuar përsëri mangësi të tilla.	Nuk është adresuar
----	----------	---	--	--------------------

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë tek përfituesit dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrin të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë. Më tutje, Ministri të sigurohet se pagesat të cilat nuk i takojnë kategorisë së investimeve kapitale të mos përfshihen në regjistrin e pasurisë dhe në RVF.
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurohet që vlera e pasurisë të raportohet sipas vlerës neto, siç kërkohet me rregullën financiare në mënyrë që të siguroj raportim cilësor, të drejtë dhe të vërtetë në RVF.
3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të ndërmarrë masa konkrete që të eliminoj mangësitë e evidentuara lidhur me raportimin e buxhetit të të hyrave jo tatimore në mënyrë që në të ardhmen PFV-të të pasqyrojnë pamje të plotë dhe të saktë.
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj kontrole adekuate në fushën e personelit, të zgjidhë problemin e angazhimit të punonjësve në punë dhe të ndërmerren hapat e duhur për zbatimin e legjislacionit në fuqi duke siguruar menaxhim efikas dhe efektiv të organizatës në drejtim të realizimit të objektivave të saj.
5.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që në mënyrë periodike, para përfundimit të vitit fiskal dhe para përgatitjes së PVF-ve të caktohet komisioni për inventarizim dhe sipas nevojës komisioni për vlerësim të pasurisë, në mënyrë që regjistrat e pasurive dhe raportimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë.
6.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që regjistrat e pasurisë plotësohen dhe azhurnohen sipas kërkesave të rregulloreve në fuqi në mënyrë që këta regjistra të jenë të plotë dhe të saktë.
7.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe të të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislacionit në fuqi.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm




Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Florim Beqiri, Udhëheqës i Auditimit



Jusuf Kryeziu, Udhëheqës i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Kreshnike Haziri, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter Konfrimim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Ministarstvo za Zajednice i Povratak / Ministry
for Communities and Return*

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Goran Rakic

Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Data: 12.07.2021, Prishtinë.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.